

SONILA BOÇI

**POLITIKA E SHTETIT KOMUNIST SHQIPTAR NDAJ
KOMUNITETIT ORTODOKS: RASTI I MINORITETIT GREK
(1945-1950)***

Lëvizjet populiste antifetare të vitit 1967, të cilat u finalizuan me dekretin e nëntorit të po atij viti¹, si dhe ligjësimi i procesit nga

* Kumtesë e mbajtur në Konferencën shkencore me temë: *Shteti dhe feja në Shqipëri 1912-2000*, organizuar nga Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës, më 2 dhjetor 2010.

¹ Gjatë viteve '60, politika antifetare e shtetit komunist shqiptar u shfaq haptazi. Që në fillim të atyre viteve, kinse me kërkesën e popullit, një sërë objektsh në pronësi të institucioneve fetare u mbyllën; financimet që merrnin komunitetet fetare nga buxheti i shtetit u reduktuan në mënyrë radikale; botimi i literaturës teologjike u pezullua pothuajse plotësisht (për më tepër shih: Dilaver Sadikaj, "Lëvizja revolucionare kundër fesë në vitet '60", në: *Studime Historike*, nr. 4, Tiranë: 1981, f. 111-114; Markus W. E. Peters, *Përballjet e Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Tiranë: "Ylber", 2010, f. 214-221). Shteti po përgatiste kështu terrenin për goditjen finale. Më 10 prill 1963, Presidiumi i Kuvendit Popullor miratoi dekretin nr. 3660 "Mbi disa ndryshime në dekretin nr. 743 datë 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare". Sipas këtij dekreti, "Komunitetet [fetare] që të mund të organizohen dhe funksionojnë, duhet të njihen nga shteti. Njohja bëhet me aprovimin e Statusit të tyre nga Këshilli i Ministrave" (*Gazeta Zyrtare e RPSH*, nr. 4, 18 prill 1963). Sipas të njëjtit dekret, Këshilli i Ministrave i jepej e drejta për të revokuar veprimtarinë e komuniteteve fetare, në rast se këto "shkelnin ligjet, rendin juridik dhe zakonet e mira" (*Gazeta Zyrtare e RPSH*, nr. 4, 18 prill 1963). Pasi ishin vendosur komunitetet fetare nën kontrollin e rreptë të qeverisë shqiptare, filloi fushata për eliminimin e besimeve fetare. Në raportin e mbajtur nga Enver Hoxha në Kongresin V të PPSH (1-8 nëntor 1966) ai e konsideroi luftën kundër ideologjisë fetare si pjesë përbërëse të luftës së klasave (*Dokumente kryesore të PPSH*, vëll. V, Tiranë: "8 Nëntori", 1974, f. 153). Kaq mjaftonte. Raportet dhe fjalimet e Enver Hoxhës ishin direktiva të qarta për t'u zbatuar nga të gjithë. Në të gjithë vendin, organet lokale të PPSH filluan të organizojnë mbledhje, në të cilat nxiteshin kryesisht të rinjtë për të vepruar kundër institucioneve fetare. Ngjarja që u trumbetua më shumë ishte "iniciativa" kundër objekteve të kultit e nxënësve të gjimnazit "Naim Frashëri" në Durrës, e cila shërbeu si shembull për të gjithë vendin. Më 27 shkurt 1967, KQ i PPSH u dërgoi një letër komiteteve të Partisë në rrethe, ku i udhëzonte ato mbi zhvillimin e fushatës kundër fesë, paragjyqimeve

Kushtetuta e RPSSH (28 dhjetor 1976) ishin dy aktet e fundit të një drame që fillesat e saj i kishte që me ngritjen e komunistëve në pushtet. Drejtuesit e lartë të PKSH-së perceptonin dy rivalë të ideologjisë marksiste-leniniste në shoqërinë shqiptare: nacionalizmin tradicional dhe besimet fetare. Por, ndërsa nacionalizmin ia nënshtruan qëllimeve të tyre unifikuese, duke e modifikuar dhe duke i dhënë një fytyrë të re, me besimet fetare as mundnin dhe as dëshironin të ndanin pushtetin.

Aspekti ligjor i problemit

Procesi i eliminimit të ideologjisë fetare ishte gradual, por këmbëngulës dhe i vazhdueshëm. Pavarësisht dëshirës së drejtuesve komunistë për të penguar supremacinë e ideologjisë fetare, në fillimet e qeverisjes, ata u detyruan të mos i kundërviheshin haptazi asaj. Gjatë viteve 1944-1945, kur pozitat e PKSH ishin ende të dobëta dhe mbështetja e saj në popull ishte e diskutueshme, politika antifetare diskutohej vetëm në organet më të larta partiake, por jo në publik. Publikisht deklarohesh se shteti do të vazhdonte të ruante laicitetin e tij, por komunitetet fetare do të ishin të lira të ushtronin aktivitetin e tyre. Kështu, në Deklaratën për të Drejtat e Qytetarit të 23 tetorit 1944, vetëm një ditë pas krijimit të Qeverisë Provizore Demokratike, shprehej vullneti

fetare dhe zakoneve fetare. Pasi fushata e rinisë kundër objekteve të kultit kishte marrë përpjesëtime të frikshme, Presidiumi i Kuvendit Popullor dekretoi më 11 prill 1967 kalimin e të gjitha pasurive të luajtshme e të paluajtshme të komuniteteve fetare në pronësi të komiteteve ekzekutive të këshillave popullore të rretheve dhe të kooperativave bujqësore pa shpërblim (D. Sadikaj, “Lëvizja revolucionare kundër fesë në vitet ’60...”, f. 119). Pasi i zhveshi institucionet nga pronat e tyre të luajtshme dhe të paluajtshme, shteti komunist u mohoi atyre dhe statusin dhe mbrojtjen juridike. Më 13 nëntor 1967, Presidiumi i Kuvendit Popullor miratoi dekretin nr. 4337 “Mbi shfuqizimin e disa dekretëve” (*Gazeta Zyrtare e RPSH*, nr. 12, 22 nëntor 1967), i cili abrogonte të gjithë kuadrin ligjor të miratuar deri atëherë për komunitetet fetare. Shfuqizohej dekreti i Presidiumit të Kuvendit Popullor mbi komunitetet fetare i 26 nëntorit 1949, statutet e komuniteteve fetare të miratuara gjatë viteve 1950 dhe 1951, si dhe ndryshimet e bëra në vitin 1963. Ky dekret që edhe *de jure* formalizoi eliminimin e komuniteteve fetare, ishte në kundërshtim me Statutin e RPSH të 14 marsit të vitit 1946. U desh Kushtetuta e RPSSH e 28 dhjetorit të vitit 1976 për t’i dhënë luftës shtetërore kundër fesë edhe mbështetje kushtetuese. Ajo në mënyrë eksplicite pohonte se “Shteti nuk njeh asnjë fe dhe përkrah dhe zhvillon propagandën ateiste për të rrënjësuar tek njerëzit botëkuptimin materialist shkencor” (neni 37).

për të garantuar “lirinë e fesë dhe të ndërgjegjes, si dhe të drejta të barabarta për të gjitha fetë”².

Ajo që shpallte Deklarata u sanksionua më vonë edhe në Statutin e RPSH të 14 marsit 1946. Neni 16 i këtij Statuti ligjëroi në vija të përgjithshme po ato parime në të cilat ishte mbështetur historikisht politika e shtetit shqiptar në lidhje me besimet fetare: laicitetin e shtetit shqiptar; barazi të të gjitha komuniteteve fetare, ushtrimin e lirë të praktikave fetare nga të gjitha komunitetet; ndalimin që feja të shpërdorohej për qëllime politike³. Ndonëse në shumë aspekte, Statuti i RPSH i vitit 1946 ishte i ngjashëm në frymë dhe përmbajtje me Kushtetutën sovjetike të vitit 1936, të mbiquajtur staliniane, sa i takon fesë, ata kishin disa ndryshime të rëndësishme. Kushtetuta shqiptare nuk përcaktonte vetëm laicitetin e shtetit, por kërkonte t’i vendoste institucionet fetare nën kontrollin financiar shtetëror⁴. Në ndryshim nga

² *Dokumenta të organeve të larta të pushtetit revolucionar nacionalçlirimtar*, botim i Institutit të Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH, Tiranë: 1962, f. 296. Deklarata për të Drejtat e Qytetarit mbështetej te parimi i liberalizmit civil dhe nuk përmendte në mënyrë specifike minoritetet. Duke qenë se Deklarata garantonte barazi për të gjithë nënshtetasit, mund të arrijmë në përfundimin se edhe atyre u garantoheshin të drejta dhe liri si qytetarë të shtetit. Në këtë mënyrë, parimet e Deklaratës u garantonin të drejta indirekte edhe minoriteteve. Përmbajtja e saj është një shembull konkret për fazën tranzitore që po kalonte Qeveria Provizore Demokratike në vendosjen e regjimit komunist. Kjo, pasi shpallja e parimeve si: garantimi i lirisë së fjalës, mbledhjes, shtypit, e drejta e pronës etj., ishin më shumë karakteristikë e shoqërive liberale, sesa atyre komuniste. Qeveria Provizore nuk mendonte t’u përmbahej parimeve të shpallura në këtë Deklaratë. Jo më kot ajo zgjodhi këtë instrument juridik, pra deklaratën, për të shpallur të drejtat e qytetarit. Nga pikëpamja juridike deklaratat nuk kanë fuqi detyruese. Ato vetëm shpallin të drejtat, por nuk i garantojnë ato.

³ Asambleja Kushtetuese, *Statuti i RPSH*, Tiranë: Shtypshkronja “Bashkimi”, 1946. Parimet e kësaj kushtetuese kanë ngjashmëri me ato të Statutit të Republikës Shqiptare të vitit 1925 dhe Statutit të Mbretërisë Shqiptare të vitit 1929. Neni 5 në të dy Statutet shprehej se “Shteti shqiptar nuk ka fe zyrtare. Të gjitha fetë e besimet janë të nderueme dhe lirija e ushtrimit dhe e praktikimit të jashtëm të tyre asht e sigurueme. Feja nuk mund të shkaktojë pengime juridike në asnjë mënyrë. Fetë dhe besimet nuk mund të përdoren për qëllime politike”.

⁴ Paragrafi i fundit i nenit 16 shprehej qartë në lidhje me këtë: “Shteti mund të ndihmojë materialisht komunitetet fetare”. Ky paragraf ishte në sinkron me disa vendime të marra për ndërprerjen e lidhjeve të komuniteteve fetare me institucionet bamirëse të huaja. Në këtë mënyrë, duke krijuar pengesa për të marrë ndihma

kjo, Kushtetuta sovjetike garantonte lirinë e kultit dhe vinte shenjën e barazimit ndërmjet propagandës shtetërore ateiste dhe asaj fetare. “Me qëllim për t’i siguruar qytetarëve lirinë e ndërgjegjes, - thuhej në Kushtetutën sovjetike, - kisha në BRSS është e ndarë nga shteti dhe shkolla nga kisha. Liria për të ushtruar kultet fetare dhe liria e propagandës antifetare u garantohet të gjithë shtetasve”⁵.

Për më tepër, ndërsa në këto akte themelore të shtetit shqiptar shpallehin dhe garantoheshin liritë fetare dhe barazia e të gjitha komuniteteve fetare, deri në vitin 1949 nuk u miratua asnjë akt ligjor apo nënligjor në mbështetje të këtyre ligjeve themeltare. Qeveria komuniste e përdori këtë vakum ligjor për të ulur *de facto* ndikimin e klerit në jetën shoqërore shqiptare.

Çfarë përfaqësonte komuniteti ortodoks në Shqipëri?

Komuniteti ortodoks në Shqipëri ishte një komunitet mjaft kompleks dhe disi heterogjen. I shtrirë kryesisht në Shqipërinë e Jugut, ai kishte qenë vazhdimisht nën trysinë ekonomike e politike, si dhe propagandës helenizuese të qarqeve nacionaliste greke. Kanë dalë nga ky komunitet ikona të nacionalizmit shqiptar si: Papa Kristo Negovani, Petro Nini Luarasi, Fan S. Noli, Themistokli Gërmenji e Dr. Mihal Turtulli, por edhe elementë filogrekë. Në përbërje të këtij komuniteti ishin dhe minoritetet greke, malazeze dhe maqedonase.

Përbërja heterogjene e komunitetit ortodoks, veçanërisht ekzistenca në të e minoritetit grek, kërkonte një politikë të kujdesshme nga ana e shtetit shqiptar. Por, kur vinte fjala për fenë, ndryshe nga sa kishte bërë për arsimin, qeveria shqiptare nuk kishte ndërmend të ndiqte një politikë të diferencuar. Në aspektin fetar, minoriteti grek u trajtua njësoj si pjesa tjetër e popullsisë shqiptare.

Politika fetare e shtetit shqiptar dhe minoriteti grek

Vitet 1944-1946 ishin veçanërisht të vështira për drejtuesit komunistë si në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Të ndërgjegjshëm se nuk mund ta shpallnin hapur konfliktin e tyre me fenë,

financiare nga palë të treta, shteti shndërrohej në të vetmin financues të komuniteteve fetare.

⁵ Ladislao Kania, *Il bolscevismo e la religione*, Roma: “Magi-Spinetti”, 1945, f. 35.

ata kërkuan dhe gjetën mënyrën për të shfrytëzuar sa më shumë në dobi të tyre. Drejtuesve të lartë shtetërorë u duhej gjithë mbështetja e mundshme e komunitetit ortodoks në Shqipëri për t'iu kundërvënë pretendimeve territoriale që vinin nga shteti fqinj, Greqia.

Në përfundim të Luftës së Dytë Botërore, ashtu siç kishte ndodhur edhe më herët në periudha kthesash historike, komuniteti ortodoks u vendos para një prove të vështirë. Qeveria greke, ende pa përfunduar lufta, nxitoi të parashtronte në kancelaritë e Aleatëve të Mëdhenj pretendimet territoriale ndaj Shqipërisë. Ashtu si dhe më parë, këto pretendime u mbështetën edhe në kritere etnike. Feja ortodokse e një pjese të konsiderueshme të banorëve të Shqipërisë së Jugut u bë “kali i betejës” për Athinën zyrtare. Kishte shqiptarë ortodoksë filogrekë dhe minoritarë nacionalistë, të cilët u vunë në shërbim të pretendimeve zyrtare greke. Këta në bashkëpunim edhe me qarqet ekstremiste nacionaliste të përtej kufirit u grumbulluan në Sillogjet Vorio-Epirote. Një nga më aktivët prej tyre ishte Komiteti Qendror i Lëvizjes Vorio-Epirote, i cili drejtohej nga ish-peshkopi i Gjirokastrës, ortodoksi korçar, Pandeimon Kotoko. Për shkak të veprimtarisë së tij antishqiptare, ai filloi të konsiderohej nga shtypi nacionalist grek si “shpirti i përpjekjes greke për Vorio-Epirin”⁶.

Pandeimon Kotoko kishte mbështetjen e qarqeve të larta kishtarë të Athinës, madje dhe të kryepeshkopit grek në Boston, si dhe të Lëvizjes Panepirotike në SHBA. Në muajin maj 1946, ai zhvilloi një vizitë në SHBA, gjatë së cilës arriti të siguronte një seancë dëgjimore në Komisionin e Jashtëm të Kongresit të SHBA. Pyetjes të këtij Komisioni se si shpjegohej fakti që të krishterët ortodoksë të Shqipërisë së Jugut, për të cilët Athina zyrtare pretendonte se ishin grekë, flisnin shqip, Kotoko u përgjigj: “I pari unë jam shqiptarofon. Dhe dy nga anëtarët e Komisionit që ndodhen në këtë çast para jush janë shqiptarofonë. Por, në këtë atdheun tonë grek, gjuha nuk ka të bëjë me ndërgjegjen. Ndërgjegjja ka qenë kurdoherë greke, sepse shpirti i Vorio-Epirit ka qenë kurdoherë grek me gjithë shtypjen dhe martirizimin e okupatorëve”⁷. Kjo veprimtari prej renegati e një kleriku të lartë të KOASH-it krijoi një situatë mjaft të rrezikshme për integritetin territorial të shtetit shqiptar. Një nga këto

⁶ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), viti (më tej: V.) 1946, dosja (më tej: D.) 128/2, fl. 31, Gazeta “Vorio Epiros” e Janinës.*

⁷ *Po aty, V. 1946, D. 128/2, fl. 31, 26 maj 1946.*

është miratimi më 29 korrik 1946, nga Senati Amerikan i rezolutës Paper⁸ që parashikonte se “Epiri i Veriut (duke përfshirë Korçën) dhe Dodekanezi duhet t’i kalonin Greqisë”⁹.

Ndaj kësaj veprimtarie në dëm të interesave kombëtare shqiptare, qeveria e kryesuar nga Enver Hoxha duhej patjetër të reagoje. Ajo kërkoi t’i tregonte opinionit ndërkombëtar se, jo vetëm ortodoksët në Shqipëri nuk ndjeheshin grekë dhe nuk dëshironin bashkimin me Greqinë, por edhe minoriteti grek ndjehej mjaft mirë nën juridiksionin e shtetit shqiptar. Me këtë qëllim, veçanërisht gjatë gjysmës së parë të vitit 1946 u kërkua nga grupe të ndryshme klerikësh ortodoksë të dërgoheshin telegrame në institucione të ndryshme ndërkombëtare në mbështetje të qeverisë shqiptare. Nuk ishte rastësi që pikërisht më 23 maj 1946, priftërinjtë e n/prefekturave Delvinë, Konispol dhe Sarandë zhvilluan një mbledhje, në përfundim të së cilës u dërgua një telegram për qeverinë shqiptare. Në të thuhej: “Ne kemi qenë dhe do të jemi kurdoherë të patundur nga qeveria popullore. Këtë le ta dëgjojnë të gjithë [që] neve protestojmë kundër provokimeve të poshta të Athinës”¹⁰. Këtë telegram e kanë firmosur edhe dy prej klerikëve me kombësi greke Papa Jorgji Papas dhe Vasil Xoxas.

Qasja e politikës së Athinës në dëm të Shqipërisë, nuk shkaktoi ndonjë reagim të ashpër të shtetit shqiptar ndaj minoritetit grek edhe përse i takon çështjeve fetare. Ndonëse kontrollohej nga shumë afër, minoriteti grek ruajti disa nga të drejtat fetare që kishte pasur në

⁸ Rezoluta e mori emrin nga referuesi mbi çështjen e pretendimeve greke pranë Senatit, senatori Cloude Denson Paper.

⁹ B. B. Papadakis, *Histoire diplomatique de la question Nord-Epirote (1912-1957)*, Athenes: Imprimerie J. Alevropoulos, 1958, f. 172, Sipas historianit grek Papadakis, ky vendim i Senatit kishte përcaktuar qëndrimin e delegacionit të SHBA në Konferencën e Paqes në Paris. Por pas reagimit të qeverisë shqiptare, Sekretari amerikan i Shtetit, Dean Acheson, i kërkoi misionit amerikan në Shqipëri që t’i bënte me dije Enver Hoxhës se rezoluta e miratuar nga Senati “... nuk duhej të konsiderohej si një qëndrim i krahut ekzekutiv, të qeverisë së SHBA”. Kjo do të thoshte se rezoluta në fjalë, kishte më shumë vlerë morale dhe nuk mund të konsiderohej linjë politike e SHBA në lidhje me pretendimet greke për Shqipërinë e Jugut. Për më tepër mbi këtë çështje shih: NARA, 710/710 American-Albanian Relations; si dhe W. Bland & J. Price, *A tangled web – a history of Anglo-American relation with Albania*, London: 1986, f. 242.

¹⁰ AQS, F. 490, V. 1946, D. 5, fl. 19, Telegram i priftërinjve të Delvinës, Sarandës, Konispolit për Qeverinë Demokratike, 25 maj 1946.

periudhën midis Dy Luftërave. Sinodi i KOASH-it vazhdoi të emëronte në kishat e zonës minoritare klerikë vendas, të cilët i kryenin ritualet në greqisht. Madje, sipas dokumenteve të KOASH-it, një pjesë e klerikëve të emëruar nuk flisnin fare shqip, kurse pjesa tjetër dhe pse e flisnin shqipën nuk dinin ta shkruanin atë. Pjesa më e madhe e klerikëve shërbenin në fshatin e lindjes ose në fshatra të afërta. Pra, nuk duken shenja persekutimi në kryerjen e riteve fetare në gjuhën amtare. Ky mesa u vu re, ishte i vetmi lëshim që shteti shqiptar kishte ndërmend t'i bënte minoritetit grek, në lidhje me besimin fetar. Komuniteti ortodoks minoritar, ashtu si të gjitha komunitetet fetare në Shqipëri, iu nënshtrua një politike antifetare që pas vitit 1946 po bëhej më e dukshme.

Fillimisht qeveria shqiptare rrënoi *pozitat ekonomike* të komuniteteve fetare. Ligji i Reformës Agrare i gushtit 1945, ndërsa u dha tokën e bejlerëve shqiptarë, popullsisë minoritare, nuk kurseu, ndër të tjera, edhe pronat e institucioneve fetare të minoritetit grek. Për të përligjur këtë veprim, si një masë që nuk drejtohej kundër fesë, në gazetën *Bashkimi* të 2 shtatorit 1945, u botua një artikull, në të cilin paraqiteshin aspekte të politikës fetare në Rusinë Sovjetike. Zhveshja e institucioneve kishtarë nga pronat, sipas artikullshkruesit, nuk kishte të bënte me persekutimin e shtetit ndaj kishës, por kthimin e kësaj të fundit në misionin fillestar të saj, pra në udhëzimet fillestare të Krishtit, duke e afruar më shumë kishën me masat popullore¹¹. Përveç humbjes së pronave si pasojë e Reformës Agrare, klerikët dhe institucionet fetare të minoritetit grek, nuk mundën më të përfitonin dhe nga një burim tjetër të ardhurash, ato të subvencioneve që merrnin nga institucionet kishtarë të shtetit grek. Kjo situatë çoi në rrënimin ekonomik të institucioneve fetare të minoritetit dhe humbjen e mundësisë së tyre për kryerjen e misionit të tyre humanitar.

Ndërsa nuk mund ta godiste hapur ideologjinë fetare, PKSH nuk hezitoi që në fillimet e pushtetit të vet të godiste klerikët. Të konsideruar si bashkëpunëtorë me pushtuesit shumë klerikë të lartë katolikë u arrestuan që në vitet e para të ardhjes së komunistëve në pushtet. Nën kontroll të rreptë u vendosën dhe klerikët e lartë të KOASH-it si: kreu i

¹¹ Dushan Rashkoviç, prift prej Ravnik Kotara “E vërteta mi fenë dhe kishën në Rusinë Sovjetike”, *Bashkimi*, 2 shtator 1945, f. 3.

saj, Kristofor Kisi, Visarion Xhuvani etj¹². Luftës së klasave që preku edhe komunitetet fetare, nuk i shpëtuan edhe klerikët minoritarë. Që nga janari i vitit 1946, në zonën e minoritetit filloi një fushatë arrestimesh për individë që konsideroheshin kundërshtarë të regjimit. Nga 19 vetët e arrestuar, katër ishin klerikë, të cilët akuzoheshin për veprimtari armiqësore. Në mënyrë të drejtpërdrejtë, ata akuzoheshin se i kishin shërbyer qarqeve vorio-epirote greke në dëm të interesave kombëtare shqiptare¹³. Krahas masave ekstreme në eliminimin e klerikëve, që nga viti 1947, organet shtetërore në shumë mënyra filluan të ndërhyjnë pranë KOASH-it për emërimet e reja të tyre, një masë kjo që ishte në kundërshtim me ligjet e miratuara nga vetë shteti komunist.

Konflikti me klerikët dhe dobësimi ekonomik i institucioneve fetare ishte vetëm njëra anë e medaljes. Feja, sipas udhëheqjes komuniste, i largonte masat nga edukimi marksist dhe i tërhiqte vëmendjen nga ndërtimi i socializmit. Kështu vëmendja kryesore e PPSH në konfliktin e saj me besimet fetare, ishte dekurajimi i popullsisë për të ndjekur ritet fetare, si pjesë e përpjekjeve të tyre për indoktrinimin komunist. Këto përpjekje filluan që në vitet e para të ardhjes së komunistëve në pushtet. Reforma arsimore e 17 gushtit 1946 sanksionoi në vijim të traditës së shkollës shqipe, laicitetin e shkollës shqiptare. Por edhe në këtë aspekt, qeveria komuniste shkoi më larg. Duke hequr nga planet mësimore shkollë lëndën e edukimit fetar dhe historisë së religjioneve, ajo nuk kërkonte të krijonte një shkollë laike, por të hidhte hapat për krijimin e një brezi ateistësh, të indoktrinuar me ideologjinë marksiste-leniniste. Shteti e shpalli veten si të vetmin institucion që mund të kryente

¹² Si mjet i luftës kundër klerikëve ortodoksë shërbyen dhe provokimet e bëra nga punonjës së Sigurimit të Shtetit. Petrit Bidoshi kujton: “Besnikët ortodoksë që kanë qenë në darkën e Krishtlindjes së vitit 1947, në Kishën Katedrale të Tiranës nuk do ta harrojnë kurrë atë natë. Në kohën e ceremonisë fetare që e printe imzot Kisi, hyri në kishë një grup sigurimsash të cilët filluan të tallen me zë të lartë dhe të fyenin të pranishmit. Kur një nga epitropët e kishës u tërhoqi vërejtjen duke iu lutur të shkonin ata e arrestuan para syve të kryepeshkopit plak dhe besnikëve të tmerruar. ... Të nesërmen ministri i Punëve të Brendshme, Koçi Xoxe, nuk denjoi ta pranonte kryepeshkopin që shkoi të protestonte”. Petrit Bidoshi, “Kisha Autoqefale Shqiptare dhe problemet e saj të sotme”, në: *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, përmbledhje kumtesash të simpoziumit të mbajtur në Tiranë, 19 shtator 1992, Tiranë: “A. Z. Çajupi”, 1993, f. 75-76.

¹³ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Brendshme* (më tej: AMPB), Fondi i proceseve hetimore e gjyqësore, viti 1946, dos. 1066.

edukimin e rinisë. Filloi në këtë mënyrë edukimi i institucionalizuar i rinisë me dashurinë për shtetin dhe partinë.

Nuk ishte vetëm në institucionet shkollore, ku ishte e ndaluar të flitej për fenë, shteti dekurajoi edukimin fetar edhe jashtë tyre. Pas marrjes së vendimit për mbylljen e shkollave fetare, disa klerikë me iniciativën e tyre, filluan të bënin kurse pranë kishave. Në verën e vitit 1946, organet e Sigurimit të Shtetit kishin pikasur se Visarion Xhuvani, peshkopi i Vlorës dhe Beratit kishte krijuar një kor të kishës me fëmijë të moshës shkollore. Menjëherë u kërkua nga komiteti i partisë së qarkut të Vlorës të gjendeshin mënyra që të pengoheshin fëmijët për të kënduar në këtë kor.

Në të njëjtën mënyrë u dekurajuan njerëzit të ishin aktivë në ndjekjen e praktikave dhe riteve fetare. Fillimisht, në fokus të këtyre pengesave ishin komunistët dhe anëtarët e rinisë komuniste. Kështu, në mbledhjen e plenumit të komitetit qarkor të Gjirokastrës, drejtuesi i organizatës së PKSH së fshatit minoritar të Sotirës, kritikohet sepse ai dhe familja e tij vazhdonte të shkonte në meshën e të dielës¹⁴.

Në prill të vitit 1947, me anë të një qarkoreje KQ i PKSH, njoftonte të gjitha komitetet e partive të rretheve për të filluar propagandën antifetare në shkolla dhe në sektorë të tjerë të shoqërisë¹⁵. Duket se lufta e shtetit kundër fesë, po hynte në një fazë të re, por ende nuk ishte shfaqur hapur. Menjëherë u vu re reagimi i organeve partiake edhe në zonën minoritare. Në një raport që komiteti qarkor i PKSH për Gjirokastrën i dërgonte KQ të PKSH, vihej në dukje se një nga problemet e hasura në punën politike me masat ishte dhe influenza e klerit. Raporti vinte në dukje se në qarkun e Gjirokastrës dy ishin zonat në të cilat kleri kishte influencë të madhe: zona e minoritetit dhe disa krahina të Tepelenës¹⁶. Ideologjia fetare doli hapur si ideologji armike. Kështu, më 30 prill 1947, komiteti qarkor i PKSH për qarkun e Vlorës njoftonte KQ të PKSH se gjatë muajve mars-prill reaksioni është paraqitur nën maskën fetare. Sipas tij, kleri ortodoks me qëllim që t'i tërhiqte vëmendjen

¹⁴ AQSH, F. 14/ Arkivi i Partisë (më tej: AP) (strukturë), V. 1946, D. 74, fl. 32.

¹⁵ Peter R. Prifti, *Socialist Albania since 1944: Domestic and foreign developments*, Cambridge, Massachusetts, London: The MIT Press, 1978, f. 154.

¹⁶ AQSH, F. 14/AP, V. 1947, D. 75, fl. 100.

masave nga problemet politike, po përpiqej t'i bënte ato të preokupoheshin më shumë për problemin fetar¹⁷.

Si kundërpërgjigje, organet partiake morën disa masa: filloi të shtohet përqendrimi i vëmendjes në shtimin e numrit të sallave të leximit dhe shtëpive të kulturës, ku rinia bombardohej me propagandë marksiste dhe antifetare. Veçanërisht u tregua kujdes në zonën minoritare. Në vitin 1947, raportohet se në të gjithë këtë zonë ishin hapur 20 shtëpi kulture¹. Në raportet e ndryshme lavdërohet veçanërisht shtëpia e kulturës e fshatit minoritar Bularat. Atje ishte krijuar një grup teatror-koral, i cili jepte shfaqje në të gjitha fshatrat minoritare¹⁸.

Në bazë të Ligjit nr. 155, datë 9 nëntor 1945 “Mbi të kremtet zyrtare”, Krishtlindjet, Pashkët, Dita e Ujit të Bekuar dhe disa festa të tjera fetare ishin njohur si ditë pushimi¹⁹. Pavarësisht kësaj, organet partiake qendrore, nxisnin ato lokale për të gjetur mënyra si p.sh. duke organizuar punë vullnetare, apo aktivitete të tjera kulturore e politike, të cilat pengonin popullsinë të merrte pjesë në këto kremtime. Në zonën e minoritetit, në disa raste autoritetet politike lokale kishin ndaluar fshatarët të kremtonin festat e të shenjtëve mbrojtës të fshatit, gjë që kishte shkaktuar dhe reagimin e banorëve. Për ta, krishterimi ortodoks ishte elementi themelor i kulturës së tyre tradicionale dhe i konstitucionit të tyre shpirtëror. Një pjesë e mirë e zakoneve dhe e riteve të këtyre minoriteteve ishin të lidhura me besimin e krishterë të ritit ortodoks. Ndryshe nga kombi shqiptar, që në themel të identifikimit kombëtar ka gjuhën shqipe, për minoritetin grek, si pjesë përbërëse e kombit amë, besimi fetar është shumë i rëndësishëm për identitetin kombëtar.

Më 26 nëntor 1949, u miratua Dekretligji “Mbi komunitetet fetare”. Parimisht ky duhet të ishte një lajm i mirë për komunitetet fetare, pasi do t'u siguronte atyre pavarësinë e kërkuar, do t'i vendoste ato nën një mbrojtje juridike, si dhe do të ndërpriste arbitraritetin shtetëror ndaj tyre. Në të vërtetë, miratimi i dekretligjit u hartua në bazë të nevojave politike shtetërore. Ai sanksionoi forcimin e ndërhyrjes shtetërore në jetën e

¹⁷ *Po aty*, D. 74, fl. 32, Raporti i muajit mars-prill i komitetit qarkor të PKSHE të prefekturës Vlorë për KQ të PKSHE.

¹⁸ *Po aty*, D. 124, fl. 27, Raport i Komitetit qarkor të PKSHE për Gjirokastrën për punën gjatë vitit 1947.

¹⁹ Kryesia e Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar, “Ligjë nr. 155, datë 9. 11. 1945, mbi të kremtet zyrtare”, në: Xhelal Gjeçovi, *Pushtimi gjerman në Shqipëri 8 shtator 1943-29 nëntor 1944*, Tiranë: “Mësonjëtorja”, 2004, f. 158-159.

brendshme të komuniteteve fetare. Sipas këtij ligji, Sinodi i KOASH-it ishte i detyruar të merrte miratimin e Këshillit të Ministrave për të gjitha emërimet e klerikëve, qoftë dhe atyre të niveleve të ulëta.

Edhe Statuti i KOASH-it i miratuar nga Kongresi i III i komunitetit ortodoks (shkurt 1950)²⁰, ndiqte linjat e përcaktuara nga Dekretligji mbi Komunitetet Fetare. Statuti i përshtatej nevojave të regjimit komunist për të politizuar dhe ideologjizuar edhe komunitetet fetare. Ai theksonte se kisha ortodokse, krahas detyrave të saj kanonike do të përpiqej të nxiste dashurinë për Republikën Popullore dhe socializmin. Sa i takon minoriteteve, Statuti i vitit 1950, ndryshe nga ai i vitit 1929 kishte disa përparësi. Kështu, Statuti sanksiononte gjuhën shqipe si gjuhë zyrtare të kishës, por gjithashtu njihte edhe meshimin në gjuhë të tjera. Me këtë u sigurohej minoriteteve e drejta të mëshonin në gjuhët e tyre amtare²¹. Përveç kësaj, në këtë Statut nuk parashikohej që klerikët e lartë të KOASH-it të kishin domosdoshmërisht kombësi dhe shtetësi shqiptare, ashtu siç sanksionohej në vitin 1929. Sipas këtij Statusi, të gjithë funksionarët dhe personeli i Kishës duhet të jenë shtetas shqiptarë të ndershëm, besnikë të popullit dhe të atdheut dhe të gëzojnë të gjitha të drejtat civile. Siç kuptohet qartë edhe nga këto dispozita, besnikëria politike do të ishte kusht edhe në emërimin e klerikëve ortodoksë. Pas kësaj, formularëve biografikë të klerikëve, krahas të dhënave për përgatitjen kanonike, iu shtuan dhe pyetje mbi bindjet e tyre politike, mbi qëndrimin e tyre gjatë Luftës Nacionalçlirimtare dhe prova që dëshmonin për besnikëri të tyre ndaj regjimit komunist në Shqipëri²². Ndërsa sërish në zonën e minoritetit klerikët ishin vendas, të bie në sy niveli tejet i ulët kulturor i një pjese të mirë të tyre.

Si Dekretligji për Komunitetet Fetare, ashtu dhe Statuti i KOASH-it pasqyruan situatën reale në të cilën shteti kishte vendosur komunitetet fetare. Ato kërkonin tkurrjen e ndikimit të besimeve fetare në jetën shoqërore të vendit deri në marginalizimin e plotë të tyre.

²⁰ Statuti i KOASH-it hyri në fuqi më 4 maj 1950 me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

²¹ Aurela Anastasi, "Statuti i Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare dhe evoluimi i tij", në: *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale ...*, f. 58.

²² *AQSH*, F. 490, V. 1953, D. 1165, E gjithë dosja ka biografitë e klerikëve ortodoksë, të cilët kanë marrë miratimin e Këshillit të Ministrave.

Në vend të përfundimit ...

Disa studiues e kanë konsideruar fushatën antifetare të qeverisë komuniste të Enver Hoxhës sikur ishte drejtuar drejtpërdrejt kundër minoritetit grek. Kështu, studiuesi grek Psalidas, duke mbështetur idenë se fushata antifetare drejtohej vetëm kundër identitetit kombëtar të minoritetit grek, shkruan se “qarqet nacionaliste të Tiranës kuptuan se kishin arritur në një konkluzion të gabuar kur zbuluan se, përveç anëtarëve të minoritetit grek, kishte gjithashtu shqiptarë, vllahë dhe sllavë që iu bashkuan kishës ortodokse pas rënies së regjimit të vjetër [kupto: komunist]”²³. Ka studiues të tjerë, të cilët mendojnë se minoritetet, për kushtet e tyre të veçanta e ndjenë më fort impaktin negativ të fushatës antifetare, se sa populli shqiptar në tërësi²⁴. Për verifikimin e kësaj teze, lypset një studim i një natyre më sociologjike, gjë që kapërcen objektin e kësaj trajtëse. Ashtu siç është përmendur më sipër në këtë trajtëse, politika antifetare e qeverisë komuniste në Shqipëri nuk drejtohej kundër minoriteteve në përgjithësi, apo atij grek në veçanti.

Në të vërtetë, politika ateiste e cila çoi edhe në një fushatë antifetare ishte një dukuri e njohur në të gjitha shtetet ku u instalua regjimi komunist. Në Shqipëri, ajo pavarësisht se shkoi më larg se në vende të tjera komuniste, kurrsesi nuk drejtohej kundër minoritetit grek, apo minoriteteve të tjera. Masat kundër besimeve fetare kishin karakter të përgjithshëm. Madje për disa komunitete, siç ishte ai i katolikëve shqiptarë, ai filloi më herët dhe ishte më i egër²⁵. Regjimi komunist nuk mund të lejonte pluralizmin e ideve, madje dhe kur ky shfaqej në formën e ideologjisë fetare. Për më tepër, ideologjia marksiste që mbështeste PKS-h bazohej mbi materializmin dialektik, i cili ishte në kundërshtim të plotë me spiritualizmin dhe të mbinatyrshmen, në të cilat mbështetej feja.

²³ Grigori Psalidas, “Democratisation versus Nationalism in Post-communist Eastern Europe: the Case of Albania and its Greek Minority”, në: *Ethnicity and Nationalism in East Central Europe and the Balkans* edited by Thanasis D. Sfikas, and Christofer Williams, Ashgate: 1999, f. 180-181.

²⁴ Hugh Poulton, *The Balkans, Minorities and the States in Conflict*, 2nd edition, Minority Rights Publication, 1994, f. 196.

²⁵ Për më tepër mbi marrëdhëniet e shtetit komunist shqiptar me komunitetin katolik shih: Markus W. E. Peters, *Përballjet e Kishës Katolike në Shqipëri ...*, f. 137-145.